



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 2, datë 14.4 2010

PËR

“ SHPALLJEN E ZONËS UJËMBLEDHËSE TE BURIMIT TE BOGOVES, SI ZONE E MBROJTJES SE VEÇANTE”

Ne mbështetje të nenit 42, të Ligjit nr. 8093, date 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, dhe me propozim të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Seman, të shprehur me vendimin nr. 2, datë 14.4.2010 Këshilli Kombëtar i Ujërave,

VENDOSI:

1. Te miratojë propozimin e Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Seman, për shpalljen e Zonës së basenit ujëmbledhës të burimit të ujit të pijshëm Bogovë si zonë të mbrojtjes së veçantë.
2. Zona e mbrojtjes së veçantë është e përcaktuar me koordinatat e vijës ndarëse dhe hartës që janë aneksi 1 i këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike dhe Transporteve dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Salj BERISHA

Fatmir MEDIU
Zv/kryetar i K.K.U

dhe

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe
Aministrimit të Ujërave

